



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1513/24 Datë: 05/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore MSc 120 R me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Materiale dhe Metalurgji BSc 180 R me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik.*
 - *Materiale dhe Metalurgji MSc 120 R me kuotën maksimumi 10 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore MSc 120 ECTS R</i>	Aziz Behrami Mirsade Gashi
2.	<i>Materiale dhe Metalurgji BSc 180 ECTS R</i>	Muharrem Zabeli Zarife Bajraktari Gashi Nazmi Hasi
3.	<i>Materiale dhe Metalurgji MSc 120 ECTS R</i>	Nurten Deva Izet Ibrahim

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë : Kiriaki Zinaovidou, Jasna Novak, Stefania Armaselu, Mauro Zarelli dhe Giga Khositashvilli.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


- Për programin e studimit; *Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore MSc 120 ECTS***, më 10.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Materiale dhe Metalurgji BSc 180 ECTS***, më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht gjashtë (6) kurse Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Materiale dhe Metalurgji MSc 120***, më 16.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) kurse Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126 të mbajtur më datë 22.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

